



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS ISHËM - ERZEN

VENDIM

Nr. 13 datë 7.03.2014

Për

Zgjidhje kontrate koncensionare për përdorim të rezervës ujore inbotilim kërkuar nga subjekti “AIS” Sh.p.k. Autostrada Tiranë-Durrës, Tiranë.

Në mbështetje, të nenit 55 pika 1 (c) “Revokimi e shfuqizimi i autorizimeve dhe lejeve dhe zgjidhja e kontratës koncensionare”, të Ligjit 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Ujrave”, të shkresës datë 20.06.2011, subjekti “AIS” Sh.p.k. raporton për ndërprerje të aktivitetit, të shkresës nga Drejtoria e Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, Nr.30404/1 datë 27.04.2012 “Kthim përgjigje” për Prefekturën e Qarkut (Sektori i Kompetencave Vendore), subjekti “AIS” Sh.p.k. nuk del i regjistruar pranë Drejtorisë Tatimore, të nenit 13 të kontratës koncensionare me palë A.U.B. Ishëm-Erzen dhe Subjekti “AIS” Sh.p.k. (koncensionari), parashikon:

Zgjidhja e kontratës do të bëhet në rastet kur koncensionari është deklaruar i falimentuar.....etj, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Ishëm – Erzen:

VENDOSI

1. Shfuqizimin e vendimit Nr.21 date 28.10.2005, ndërprerjen e marrëdhënies kontraktore për përdorim të rezervës ujore me subjektin “AIS” Sh.p.k.
2. Ngarkohet A.U.B. Ishëm – Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI A.U.B
ISHËM – ERZEN**
Shpëtim MEDIU



**KRYETARI I K.B.U
ISHËM – ERZEN**

Sadi VORPSI

